

VENDIM
Nr. 115, datë 8.7.2016

**MBI PËRCAKTIMIN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 8, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

2. Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”, parashikohet se: “Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit”.

3. Me VKM nr. 244, datë 30.3.2016 janë miratuar “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

4. Në VKM nr. 244, datë 30.3.2016 është parashikuar se: “Detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjera KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përcaktojë përkohësisht OSHEE sh.a. në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike, nga data 1 korrik 2016 deri në 31.12.2016.

2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit, sipas parashikimeve të vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti